Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0601

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Kryetar, panelist individual, duke vendosur sipas ankesës së OE PROGLOBAL SH.P.K., kundër Vendimit për anulimin e procedurës së prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim dhe servisim i aparateve për fikjen e zjarrit" me numër të prokurimit 615-23-5360-1-3-6, inicuar nga Autoriteti kontraktues (AK) – KOMUNA E PODUJEVËS, më 18/10/2023, mori këtë:

Vendim

1. Anulohet në tërësi, aktiviteti i prokurimit "Furnizim dhe servisim i aparateve për fikjen e zjarrit", me numër të prokurimit 615-23-5360-1-3-6, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – KOMUNA E PODUJEVËS.

2. Lejohet kthimi i mjeteve të depozituara në emër të tarifës ankimore sipas paragrafi 4, 5 të nenit 31 të Rregullores së Punës së OSHP, kurse ankuesi ka të drejtë që sipas paragrafi 6, të dispozitës së cituar. Të kërkojë kthimin e mjeteve në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi, në të kundërtën mjetet konfiskohen dhe kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 26.05.2023 AK – Komuna e Podujevës, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar B05 Njoftimin për Kontratë për aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim dhe servisim i aparateve për fikjen e zjarrit" me numër të prokurimit 615-23-5360-1-3-6. Me datën 21.06.2023 ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues. Ndërsa me datën 09.08.2023 ka publikuar B10 – Njoftimi per anulimin e aktivitetit të prokurimit.

Lidhur me këtë Operatori ekonomik ankues " PROGLOBAL SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim.

I pakënaqur me vendimin e AK, me datën 21.08.2023 Operatori ekonomik PROGLOBAL SH.P.K., ka parashtruar ankesë në OSHP, me numër të protokollit 2023/0601.

Autoriteti Kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës furnizim, Vlera e parashikuar e kontratës: 8,000.00 €.

Me rastin e shqyrtimit paraprak, Paneli Shqyrtues konstatoi se, ankesa në rastin konkret, është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë në OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu edhe nenit 108/A të ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie në kompetencat e tij në kuptim të nenit 105 të LPP.

-*Vlerësimi dhe administrimi i provave –*

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me ketë, me 04.09.2023, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- Ankesa e OE ankues të refuzohet si e pabazuar,
- Të mbetet në fuqi Vendimin i AK.

Raporti i ekspertizës i cituar si më sipër përmban elementet qenësore dhe i njëjti i është dërguar autoritetit kontraktues dhe ankuesit. Lidhur me këtë raport të ekspertizës AK është pajtuar me mendimin e ekspertit ndërsa Operatori ekonomik ankues nuk është pajtuar me mendimin e ekspertit duke theksuar "*Kompania "ROGLOBAL" SHPK – Prishtinë, me datën 04.09.2023, ka pranuar raportin me nr. 601/2023, sipas ankesës sone te parashtruar kundër vendimit te AK – Komuna Podujeve lidhur me aktiviteitn e prokurimit "Furnizimi dhe servisimi i aparateve per fikjen e zjarrit me nr.615-23-5360-1-3-6. Kompania jone ka paraqitur pretendimet ankimore ne ankese dhe ka prezantuar faktet dhe provat, te gjitha këto prova përsëri jane mohuar dhe nuk jane prezantuar nga eksperti shqyrtues. Çështje e mos prezantimit te provave, perkatesisht lidhjes se kontratës dhe mos trajtimi i pretendimeve ankimore është shqetesuese, andaj presim qe te shqyrtohet nga Paneli i Organit Shqyrtues te Prokurimit. Kompania "PROGLOBAL" SHPK, e ka prezantuar, kontraten e lidhur per kete procedur te prokurimit. Obligim i ekspertit shqyrtues eshte qe ta njoftoj panelin shqyrtues me kontraten ne fjale. Lidhja e kontrates krijon mardhenie kontraktuale detyruese, dhe ne si kompani permes kerkese padise mund ti realiziojme te drejtat tona lidhur me demin e shkaktuar dhe fitimin e humbur. Megjithatë per hire te korrektesise dhe gjykimit te drejt përmes ankeses e kemi njoftuar Organin Shqyrtues te Prokurimit, me shkeljet*

ligjore, devijimin procedural dhe pasojat juridike. Me nenin 113, te LPP-se, obligim ligjor eshte trajtimi i pretendimeve ankimore te përfshira ne ankese, anashkalimi i tyre mund te prodhoj pasoja juridike dhe mos prezantimi i provave konsumon veprime kundërligjore penale. Ne nuk e kuptojmë pse eksperti nuk e njofton panelin shqyrtues qe per këtë procedur ka kontrat te lidhur. Kompania jone per hire te korrketesise dhe per hire te etikes profesionale, përmes ankesës se dates 21.08.2023, e ka njoftuar OSHP-ne dhe panelin shqyrtues me veprimet kunderligjore per kete procedurë te prokurimit, ku fillimisht ankesa ne OSHP, është pranuar ne kundershtim me nenin 108/A dhe nenin 109, te LPP-se, me pastaj eksperti shqyrtues i tanishem nuk i ka prezantuar provat dhe përmes vendimit paneli shqyrtues është lajthitur si nga AK – Komuna Podujeve, po ashtu edhe nga Eksperti shqyrtues. Edhe përmes këtij raporti sikurse edhe ne raportin paraprak i njëjti eksperti pretendimet tona përveç se nuk i trajton te njëjtat nuk i bene as pjesë te raportit. Se bashku me ankese gjeni kontratën e lidhur ne mes te palëve."

Përgjigje në Pretendimet Ankimore të OE ankues "PROGLOBAL SH.P.K."

- Bazuar në Nenin 114 te ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L- 092, është bërë shqyrtimi ankesës 2023/0472.

Mirëpo pasi që OE PROGLOBAL SH.P.K. ka paraqitur prapë ankesë lidhur me pretendimet ankimore të potencuara më lartë te pjesa e dispozitave të shkelura dhe pretendimet ankimore, do të përgjigjem sipas pikave të potencuara tek pozicioni dispozitat e shkelura dhe pretendimet ankimore dhe arsyet për refuzimin e ankesës si e pabazuar:

Në mënyrë që të zbatohet Neni 7, AK (Autoriteti Kontraktues), meqenëse kemi të bëjmë me furnizim për të cilin dihet sasia, Autoriteti Kontraktues do të duhej që të zbatoj Nenin 8 dhe mbi bazën e këtij neni të specifikoj edhe sasitë sipas Nenit 28 në mënyrë që të implementohet në tërësi neni 7 i Ligjit të Prokurimit Publik në Republikën e Kosovës.

Po ashtu në fillim të këtij procesi janë pranuar nga ana e AK, çmime jo reale në raport me çmimet e tregut, për artikujt e potencuar në ankesë ku kjo vjen edhe si rezultat i mos aplikimit të nenit 7, nenit 8 dhe nenit 28 të Ligjit të Prokurimit Publik në Republikën e Kosovës.

Në momentin qe nuk zbatohet nga ana e AK neni 7, neni 8, dhe neni 28 i LPP-së nuk mund te pretendohet nga ndonjë operator ekonomik se ka të drejtë në kryerjen e ndonjë procesi të prokurimit.

Me datën 19.06.2023, ka pasur vendim të mëparshëm nga ana e PSH-së lidhur me raste të ngjashme, ku pikërisht ankuesi në këtë rast ALBKOS SAFETY SHPK 811440908, ka bërë ankesë në PSH dhe vendimi i PSH-së ka qenë aprovim i pjesërishëm i bazuar. Vendimi nr.2023/0281. Ky vendim i'u është bashkangjitur ankesës nga ana e ankuesit

Andaj konform Nenit 114 pika 2, ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092 është bërë raporti shqyrtues i ekspertit për ankesën e parë 2023/0472 dhe tani ankesën e PROGLOBAL SH.P.K. si te pabazuar konform arsyetimeve te potencuara me lartë.

-Mendimi i ekspertit shqyrtues-

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

- Konstatimi i Panelit Shqyrtues -

Paneli konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, prandaj analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca publike me palë sepse ka prova të mjaftueshme për të vendosur sipas paragrafit 1, të nenit 24 të Rregullores së cituar. Paneli në ketë rast mori në konsideratë të gjitha pohimet ankimore, aktet dhe veprimet e AK dhe raportin e ekspertit.

Në fakt (natyrisht pavarësisht nga rekomandimet) Paneli vëren se procedura e prokurimit e cila është aplikuar në ketë rast është prezantuar në detaje në raportin e ekspertit shqyrtues, duke i shpjeguar të gjitha fazat e procesit dhe veprimet e ndërmarra nga palët në kontekstin krahasues me aktet në fuqi, posaçërisht me Rregullat për Prokurim Publik.

Prandaj duke ju referuar nenit 104.1, të LPP, sipas të cilit kërkohet që procedura e shqyrtimit të zbatohet në mënyrë të shpejt, të ligjshme dhe efektive dhe duke i analizuar po ashtu në tërësinë e tyre shkresat e kësaj lënde në kontekstin e këtij procesi të prokurimit, Paneli nuk e konsideroi të nevojshme ta shtjelloj sërish në detaje dhe pa nevojë në ketë rast secilin pretendim ankimor, përderisa të njëjtat në mënyrë specifike janë veçuar sidomos në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe janë analizuar dhe argumentuar pa vërejtje nga ana e këtij Paneli. Krahas tjerash, në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe në raportin e ekspertit shqyrtues janë dhenë shpjegime të drejta po ashtu edhe lidhur me pohimet ankimore. Paneli vëren se arsyet e dhëna në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues janë profesionale dhe të argumentuara pa vërejtje me prova materiale, pa nevojë që të përshkruhen sërish. Prandaj Paneli mbështet shpjegimet e ekspertit shqyrtues i cili ka shpjeguar në raportin e ekpertizës së tij se çështja e anulimit të këtij aktiviteti të prokurimit ka qenë në rekomandimin e ekspertit shqyrtues në raportin paraprak të ekspertizës për këtë aktivitet me nr. 2023/0472, i datës 23.07.2023. Andaj, lidhur me këtë OSHP ka pranuar pajtim të palëve në (autoritet kontraktues dhe OE ankues) se në zhvillimin e këtij aktiviteti të prokurimit ka pasur shkelje të dispozitave ligjore të LPP, dhe OSHP ka nxjerrë vendim me nr. 2023.0472 më dt. 07.08.2023, ku ka ndërprerë vetëm procedurën e shqyrtimit të kësaj ankese pa u lëshuar në pretendime ankimore. Por edhe konform nenit 115 të LPP, paragrafi 3, citon "Nëse,në vendiminetij,autoriteti kontraktueskonstaton sepretendimiosetëgjitha pretendimetjanë tëvlefshme,dheankuesinukka refuzuar, ai brendapesë (5) ditëve,apoafatit tëlejuarngaeksperti,dotëndërmerrçfarëdoveprimikorrigjuestërekomanduarngaeksperti përtarregulluaraktivitetineprokurimitnëpajtueshmëri me këtëligjdhetëmënjanojëaqsa është emundurçdodëmosekërcënimqë shkonnë dëmtëparashtruesittëankesësose operatorëve tëtjerëekonomik". Dhe veprim i ndërmarrë nga AK është anulimi i kësaj procedure konform rekomandit të ekspertizës, si rezultat i i këtyre shkeljeve të evidentuara nga eksperti. Rrjedhimisht për panelin shqyrtues kjo çështje është e përfunduar.

- Përfundim -

Nisur nga shpjegimet si më sipër Paneli konsideron se AK ka vepruar në harmoni me dispozitat e nenit 62 të LPP. Konform nenit 24, paragrafi 2 i LPP, autoritetet kontraktues janë përgjegjëse që gjatë zhvillimit të aktiviteteve të prokurimit të respektojnë të gjitha dispozitat ligjore të prokurimit publik.

Ndonëse mendimi i ekspertit nuk është detyrues, Paneli sipas mendimit të pavarur të tij e ka mbështetur raportin e ekspertit në rastin konkret, nisur nga parimi se vlera provuese e tij jepet gjithnjë me raport me vlerësimin, krahasimin dhe administrimin e të gjitha provave tjera dhe natyrën e një çështje në rastin konkret.

Paneli shqyrtues konsideron se vendimi i marrur në ketë çështje është i bazuar në administrimin e të gjitha provave, në dispozicion të kësaj lënde dhe se në marrjen e vendimeve gjithmonë ka parasysh nenin 1 të LPP-së, ku qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese. Paneli Shqyrtues niset gjithnjë nga fakti se autoritetet kontraktuese ushtrojnë pavarësinë e tyre institucionale në procesin e prokurimit publik, mirëpo mbetet në detyrimin e tyre eksplicit respektimi i ligjshmërisë në procesin e prokurimit.

Vendimi si në pikën 2 të dispozitivit është ngase anulimi i kësaj procedure është me fajin e AK i cili nuk ka zbatuar drejtë dispozitat ligjore të LPP dhe pa fajin e OE ankues, i cili më herët ka qenë i rekmanduar për kontratë nga AK.

Andaj nga të lartcekurat, paneli shqyrtues ne pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **KOMUNA E PODUJEVËS**
- OE - **PROGLOBAL SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: